



 [www.guideks.org](http://www.guideks.org)  
 [contact@guideks.org](mailto:contact@guideks.org), [guidesinkosovo@gmail.com](mailto:guidesinkosovo@gmail.com)  
 +383(0)49372639, +383(0)44128830  
 GuideKs  
 guidesinkosovo

Member of:



Kosovo Tourist Guide Association - Asociacioni i guidave turistike të Kosovës - Asocijacija turističkih vodiča Kosova

## RREGULLORJA 01/2025

### PËR KATEGORIZIMIN, OBLIGIMET DHE PËRFITIMET E ANËTARËSISË SË GUIDEKS

#### INFORMATA TË PËRGJITHSHME

Anëtarësimi në organizatën jo-qeveritare GUIDEKS është i hapur për çdo person pavarësisht prej racës, ngjyrës, gjinisë, gjuhës, fesë, mendimeve politike ose të tjera, prejardhjes kombëtare a shoqërore, lidhjes me ndonjë komunitet, pronës, gjendjes ekonomike, sociale, orientimit seksual, lindjes, aftësisë së kufizuar ose ndonjë statusi tjetër personal.

Anëtarët ekzistues dhe të ardhshëm të organizatës pranojnë të gjitha detyrimet e kësaj rregulloreje, duke përfshirë detyrimet që rrjedhin nga:

1. Statuti i organizatës dhe angazhohen për përmbushjen e qëllimeve dhe misionin e organizatës; si dhe
2. Kodi Etik i udhërrëfyesve turistik të anëtarësisë së GUIDEKS.

Varësisht nga prapavija profesionale anëtarët e GUIDEKS i përkasin këtyre kategorive të anëtarësisë:

- 1. Anëtar i plotë – udhërrëfyes kombëtar**
- 2. Anëtar i plotë – udhërrëfyes lokal**
- 3. Anëtar i plotë**
- 4. Anëtar i thjeshtë**

Të gjitha aplikimet për anëtarësi në GUIDEKS bëhen përmes formës së aplikimit online në ueb-faqe dhe aprovohen përmes votimit në Bord Ekzekutiv të organizatës. Të gjithë anëtarët me aprovim të Bordit Ekzekutiv automatikisht bëhen anëtarë të thjeshtë dhe kjo anëtarësi nuk ka kufizim kohor. Anëtarët e plotë duhet të përditësojnë anëtarësimin e tyre në baza vjetore duke kryer pagesën vjetore dhe dorëzuar dokumentet përkatëse për certifikim apo përvojë si udhërrëfyes turistik.

## KATEGORIZIMI I ANËTARËSISË

**1. ANËTAR I PLOTË - udhërrëfyes kombëtar** - nënkupton udhërrëfyesit kombëtar të certifikuar për tërë territorin e Kosovës. Këta anëtarë duhet të jenë të certifikuar nga programi i trajnimit të GUIDEKS me 200 orë trajnimi <sup>(1)</sup>. Si alternativë të këtij trajnimi ata duhet të jenë udhërrëfyes të certifikuar nga programe tjera relevante që kanë normën e përafërt të orëve apo kanë dëshmi përkatëse për përvojë si udhërrëfyes turistik në së paku tre rajone të Kosovës <sup>(2)</sup>. Prezenca e këtyre anëtarëve tyre llogaritet në total të kuorimit të Kuvendit të Anëtarëve, kanë të drejtë vote dhe kane bexhin identifikues të GUIDEKS.

**2. ANËTAR I PLOTË - udhërrëfyes lokal** - nënkupton udhërrëfyesit lokal të certifikuar për së paku një rajon të Kosovës. Këta anëtarë duhet të jenë të certifikuar nga programi i trajnimit të GUIDEKS me 90 orë trajnimi <sup>(1)</sup>. Si alternativë të këtij trajnimi ata duhet të jenë udhërrëfyes të certifikuar nga programe tjera relevante që kanë normën e përafërt të orëve apo kanë dëshmi përkatëse për përvojë si udhërrëfyes turistik në së paku një rajon të Kosovës <sup>(2)</sup>. Prezenca e këtyre anëtarëve tyre llogaritet në total të kuorimit të Kuvendit të Anëtarëve, kanë të drejtë vote dhe kane bexhin identifikues të GUIDEKS.

**3. ANËTAR I PLOTË** - nënkupton anëtarin e organizatës që përkrah misionin e shoqatës dhe mund të mos ketë edukim/trajnim formal për udhërrëfyes turistik. Ftohen për pjesëmarrje dhe kontribut në mbledhjet zyrtare të organizatës, por kjo pjesëmarrje nuk është obligative. Nëse marrin pjesë në takim atëherë kanë të drejtë vote në Kuvend të Anëtarëve.

**4. ANËTAR I THJESHTË** - nënkupton anëtarin e organizatës që përkrah misionin e shoqatës dhe mund të mos ketë edukim/trajnim formal për udhërrëfyes turistik. Ftohen për pjesëmarrje e kontribut në mbledhjet zyrtare të organizatës apo ide për politika të organizatës. Pjesëmarrja e tyre nuk është obligative dhe nuk kanë të drejtë vote në Kuvend të Anëtarëve.

Në rast të mungesës së certifikimit përkatës dëshmitë për përvojë mund të jenë e-mailat për rezervim nga palët e jashtme, itinerari, fotografitë nga grupet me turistë, etj.

## PËRGJEGJËSITË E ANËTARËSISË

**Të gjithë anëtarët/et, pa marrë parasysh kategorinë** që përcaktohen duhet të:

- Marrin pjesë në mbledhjet zyrtare që ftohen nga organizata;

---

<sup>(1)</sup> Programi trajnues për Certifikimin Zyrtar bazohet në Memorandumin e Bashkëpunimit të nënshkruar ndërmjet GUIDEKS, Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë së Kosovës më 11 tetor 2024 në Prishtinë. GUIDEKS është i certifikuar nga FEG për ofrimin e programeve të trajnimit për udhërrëfyesit turistik në Kosovë dhe trajnimi bazohet në parimet e standardit CEN EN 15565:2008.

<sup>(2)</sup> Rajonet e përcaktuara për kualifikim gjenden në vijim:

1. Rajoni Jug me përbërje të 7 komunave në vijim: Prizren, Dragash, Mamushë, Rahovec, Malishevë, Suharekë, Shtërpçë.
2. Rajoni Perëndim me përbërje të 6 komunave në vijim: Pejë, Gjakovë, Deçan, Junik, Istog, Klinë.
3. Rajoni Veri me përbërje të 8 komunave në vijim: Mitrovica Jugore, Mitrovica Veriore, Vushtrri, Zubinpotok, Leposaviç, Zveçan, Podujevë, Skenderaj.
4. Rajoni Qendër me përbërje të 7 komunave në vijim: Prishtinë, Graçanicë, Novobërdë, Fushë Kosovë, Obiliq, Lipjan, Drenas.
5. Rajoni Lindje me përbërje të 10 komunave në vijim: Ferizaj, Gjilan, Kamenicë, Shtime, Kaçanik, Hani i Elezit, Viti, Klllokot, Partesh, Ranillug.

- Votojnë (në takime apo platformë on-line të organizatës) për temat dhe çështjet që kanë të bëjnë me funksionim më të mirë dhe politika të organizatës (nëse kanë një të drejtë të tillë);
- Promovojnë organizatën në platforma të ndryshme ku ata/ato veprojnë;
- Ndajnë informata relevante me GUIDEKS-in dhe anëtarët e saj nga fusha e udhërrëfyesve turistikë dhe të turizmit;
- Kontribuojnë në databazën e brendshme të organizatës me informata dhe burime relevante të sektorit.

### **Obligimet e veçanta të Anëtarëve të plotë (udhërrëfyes kombëtar dhe lokal)**

Këta anëtarë kanë përgjegjësinë më të lartë për funksionim dhe mbarëvajtje të punëve të Kuvendit të Anëtarëve të GUIDEKS.

Në rast mungese të këtyre anëtarëve në takime të organizatës dhe për qëllim të mos bllokimit të kuorumit të takimit, vota e tyre duhet të delegohet me shkrim tek një anëtar tjetër i kategorisë së njëjtë.

Anëtarët që mungojnë 3 herë radhazi brenda një viti kalendarik në takimet e Kuvendit apo nuk votojnë 3 herë radhazi për çështje që kërkohen nga organizata (brenda një viti kalendarik), automatikisht kalojnë në kategorinë e anëtarit të thjeshtë.

### **PËRFITIMET E ANËTARËSISË**

|   | <b>KATEGORITË DHE PËRFITIMET</b>   | <b>ANËTAR I PLOTË<br/>UDHËRRËFYES<br/>KOMBËTAR</b> | <b>ANËTAR I PLOTË<br/>UDHËRRËFYES<br/>LOKAL</b> | <b>ANËTAR I PLOTË</b> | <b>ANËTAR I THJESHTË</b> |
|---|--|--|---|-----------------------|--------------------------|
|   | <b>Pagesa vjetore</b>  | <b>60 Euro</b>                                     | <b>35 Euro</b>                                  | <b>30 Euro</b>        | <b>Falas</b>             |
| 1 | Pjesëmarrja në Mbledhjet e Përgjithshme Vjetore (MPV) të organizatës                                 | √ *  | √ *   | √ †                   | √                        |
| 2 | Pjesëmarrja në Mbledhjet e Përgjithshme të Jashtëzakonshme (MPJ) të organizatës                      | √ *  | √ *   | √ †                   | √                        |
| 3 | E drejta e votës për çështje të politikave të organizatës (në takime apo formate on-line)            | √ *  | √ *   | √ †                   |                          |
| 4 | Pjesëmarrja në ngjarjet publike dhe aktivitetet e organizatës  | √  | √   | √                     | √                        |
| 5 | Bexhi identifikues i personalizuar për udhërrëfyesit e certifikuar me llogo të GUIDEKS / FEG / WFTGA | √  | √   |                       |                          |
| 6 | Vizitkarta e GUIDEKS për udhërrëfyesit e certifikuar me llogo të GUIDEKS / FEG / WFTGA               | √  | √   |                       |                          |

|    |  |   |   |   |   |
|----|--|---|---|---|---|
| 7  | Mundësi për trajnime me çmime promocionale të ofruara nga GUIDEKS  | ✓ | ✓ | ✓ |   |
| 8  | Mundësi për tu kandiduar dhe përzgjedhur si anëtar i Bordit Ekzekutiv  | ✓ | ✓ |   |   |
| 9  | Mundësi për ofrim të shërbimeve të udhërrëfimit në emër të GUIDEKS <sup>(3)</sup>  | ✓ | ✓ |   |   |
| 10 | Mundësi për përfshirje në projekte të organizatës varësisht profilit profesional   | ✓ | ✓ | ✓ | ✓ |
| 11 | Promovimi i profilit personal me tekst dhe foto në webfaqe dhe mediat sociale të GUIDEKS   | ✓ | ✓ |   |   |
| 12 | Promovimi në listë të anëtarëve të organizatës në ueb-faqe të GUIDEKS  | ✓ | ✓ | ✓ | ✓ |
| 13 | Përfaqësim i organizatës në media / forume / konferenca / takime të ndryshme lokale apo ndërkombëtare (Me autorizim të Drejtorit apo Bordit Ekzekutiv)                         | ✓ | ✓ | ✓ | ✓ |
| 14 | Qasja në databazën e brendshme të organizatës me informata rreth udhërrëfyesve, turizmit, lokaliteteve turistike në Kosovë, ligje, standarde, strategji dhe literaturë shtesë. | ✓ | ✓ |   |   |

\* Obligative + Jo-obligative

## PAGESA E ANËTARËSISË

Pagesa vjetore e anëtarësisë bëhet në xhirollogarinë bankare të organizatës GUIDEKS në TEB 2032 0001 6945 9542 me përshkrimin si në vijim: "Anëtarësimi për GUIDEKS viti 20XX Emri Mbiemri". Pagesa duhet të bëhet me transfer bankar/e-banking apo deponim në bankë. Nuk pranohen pagesat në kesh.

Pagesa për çdo vit kalendarik duhet të kryhen deri më 1 Shkurt të vitit përkatës nëse nuk është përcaktuar ndryshme me ndonjë njoftim shtesë nga GUIDEKS. Kjo është me rëndësi sidomos nëse anëtarët që dëshirojnë të marrin pjesë në takimin vjetor të Kuvendit ku mund të kenë edhe të drejtën e votës.

<sup>(3)</sup> Për anagazhim profesional si udhërrëfyes turistik në emër të GUIDEKS, organizata përpos pagesës së tatimeve dhe kontributeve pensionale aplikon tarifë administrative shtesë në vlerë 10% të shumës për pagesat neto mbi 80 Euro (për një angazhim).

Në rast se pagesa kryhet pas datës 1 Shkurt apo pranimi i një anëtari të ri bëhet pas kësaj date, benefitet përfitohen nga datat e pagesës. Në këto raste nuk aplikohet pagesë e pjesshme por vetëm për një vit të plotë të anëtarësisë.

Në rast të mos-pagesës së anëtarësisë në baza vjetore, anëtari/ja mbetet anëtar i thjeshtë deri në pagesë të anëtarësisë për kategorinë përkatëse.

## **PËRFUNDIMI I ANËTARËSISË**

Anëtarësimi i ndonjë anëtari mund të përfundojë ose suspendohet në bazë të nenit 4.3 të Statutit të organizatës. *"Anëtarësimi i ndonjë anëtari gjithashtu mund të përfundojë ose suspendohet me vendimin e Kuvendit të Anëtarëve në rast se anëtarit bie ndesh me statutin e organizatës, keqpërdoret pozita dhe emri i organizatës nga anëtari i caktuar, gjë që mund të shkaktojë dëmtim financiar apo të reputacionit të organizatës. Në rast të suspendimit, kohëzgjatja e suspendimit do të përcaktohet."*

Anëtari i organizatës mund të largohet edhe me vendim të GUDIEKS në rast të shkeljeve të Kodit Etik të organizatës. Në këto raste nuk aplikohet votimi në Kuvend të Anëtarëve.

Anëtari i organizatës mund të largohet me vetë-dëshirë nëse dërgon një deklaratë me email/me shkrim tek organizata ku përfshihet data e largimit dhe arsyeja. Në rast të tërheqjes së personit nga anëtarësia, organizata nuk kthen pagesën e anëtarësisë për atë vit kalendarik të paguar.

*Aprovuar më (datë) 22 shkurt 2025 në Vushtrri nga Kuvendi i Anëtarëve të GUIDIEKS.*

*Shënim: Me këtë Rregullore pushon së funksionari Rregullorja 1/2020 për kategorizimin, obligimet dhe përfitimet e anëtarësisë së GUIDIEKS e aprovuar më 26 janar 2020 dhe përditësuar më 5 mars 2022.*



 www.guideks.org  
 contact@guideks.org, guidesinkosovo@gmail.com  
 +383(0)49372639, +383(0)44128830  
 GuideKs  
 guidesinkosovo

Member of:



Kosovo Tourist Guide Association - Asociacioni i guidave turistike të Kosovës - Asocijacija turističkih vodiča Kosova

---

## REGULATION 01/2025

### ON CATEGORIZATION, OBLIGATIONS AND BENEFITS OF GUIDEKS MEMBERSHIP

#### GENERAL INFORMATION

Membership in the non-governmental organization GUIDEKS is open to any person regardless of race, colour, gender, language, religion, political or other opinions, national or social origin, association with any community, property, economic, social status, sexual orientation, birth, disability or any other personal status.

Existing and future members of the organization accept all obligations of this regulation, including obligations arising from:

1. The Statute of the organization and are committed to fulfilling the goals and mission of the organization; as well as
2. The Code of Ethics of tourist guides of GUIDEKS membership.

Depending on their professional background, members of GUIDEKS belong to these membership categories:

- 1. Full member - national guide**
- 2. Full member - local guide**
- 3. Full member**
- 4. Ordinary member**

All applications for membership in GUIDEKS are made through the online application form on the website and are approved through a vote by the Executive Board of the organization. All members with the approval of the Executive Board automatically become ordinary members and this membership have no time limit. Full members must update their membership on an annual basis by paying the annual fee and submitting the relevant documents for certification or experience as a tourist guide.

## MEMBERSHIP CATEGORIZATION

**1. FULL MEMBER - national guide** - means national guides certified for the entire territory of Kosovo. These members must be certified by the GUIDEKS training program with 200 hours of training <sup>(4)</sup>. As an alternative to this training, they must be certified guides from other relevant programs who have an approximate norm of hours or have relevant evidence of experience as a tourist guide in at least three regions of Kosovo <sup>(5)</sup>. The presence of these members shall be counted in the total quorum of the Assembly of Members, shall have the right to vote and have the GUIDEKS ID badge.

**2. FULL MEMBER - local guide** - means local guides certified for at least one region of Kosovo. These members shall be certified by the GUIDEKS training program with 90 hours of training <sup>(4)</sup>. As an alternative to this training, they must be certified guides from other relevant programs who have an approximate norm of hours or have relevant evidence of experience as a tourist guide in at least one region of Kosovo <sup>(5)</sup>. The presence of these members shall be counted in the total quorum of the Assembly of Members, shall have the right to vote and have the GUIDEKS ID badge.

**3. FULL MEMBER** - means a member of the organization who supports the mission of the association and may not have formal education/training as a tourist guide. They are invited to participate and contribute to the official meetings of the organization, but this participation is not mandatory. If they attend the meetings, they have the right to vote in the Assembly of Members.

**4. ORDINARY MEMBER** - means a member of the organization who supports the mission of the association and may not have formal education/training as a tourist guide. They are invited to participate and contribute to the official meetings of the organization or give ideas for organization policies. Their participation is not mandatory and they do not have the right to vote in the Assembly of Members.

In the absence of relevant certification, evidence of experience may include e-mails for booking from an external party, itineraries, photos from tourist groups, etc.

## MEMBERSHIP RESPONSIBILITIES

**All members, regardless of their category** they are assigned to, must:

- Participate in official meetings invited by the organization;

---

<sup>(4)</sup> The training program for Official Certification is based on the Memorandum of Cooperation signed between GUIDEKS, the Ministry of Culture, Youth and Sports and the Ministry of Industry, Entrepreneurship and Trade of Kosovo on October 11, 2024 in Prishtina. GUIDEKS is certified by FEG to provide training programs for tourist guides in Kosovo and the training is based on the principles of the CEN EN 15565:2008 standard.

<sup>(5)</sup> The regions designated for qualification are as follows:

1. Region South consisting of the following 7 municipalities: Prizren, Dragash, Mamusha, Rahovec, Malisheva, Suhareka, Shtërpçë.
2. Region West consisting of the following 6 municipalities: Peja, Gjakova, Deçan, Junik, Istog, Klina.
3. Region North consisting of the following 8 municipalities: Mitrovica South, Mitrovica North, Vushtrri, Zubinpotok, Leposaviq, Zvecan, Podujevë, Skenderaj.
4. Region Center consisting of the following 7 municipalities: Prishtina, Gračanica, Novobërdë, Fushë Kosovë, Obiliq, Lipjan, Drenas.
5. Region East consisting of the following 10 municipalities: Ferizaj, Gjilan, Kamenicë, Shtime, Kaçanik, Hani i Elezit, Viti, Kllokot, Partesh, Ranillug.

- Vote (in meetings or on-line platform of the organization) on topics and issues related to the better functioning and policies of the organization (if they have such a right);
- Promote the organization on various platforms where they operate;
- Share relevant information with GUIDEKS and its members from the field of tourist guides and tourism;
- Contribute to the organization's internal database with relevant information and resources of the sector.

### Specific obligations of Full Members (National and Local guides)

These members have the highest responsibility for the functioning and the smooth running of the work of the GUIDEKS Members' Assembly.

In case of absence of these members in meetings of the organization and in order not to block the quorum of the meeting, their vote must be delegated in writing to another member of the same category.

Members who are absent 3 times in a row within a calendar year in the Assembly meetings or do not vote 3 times in a row on issues requested by the organization (within a calendar year), automatically move to the category of Ordinary Member.

### MEMBERSHIP BENEFITS

|   | CATEGORIES AND BENEFITS  | FULL MEMBER<br>NATIONAL<br>GUIDE | FULL MEMBER<br>LOCAL<br>GUIDE | FULL<br>MEMBER  | ORDINARY<br>MEMBER |
|---|--|----------------------------------|-------------------------------|-----------------|--------------------|
|   | <b>Annual fee</b>  | <b>60 Euros</b>                  | <b>35 Euros</b>               | <b>30 Euros</b> | <b>Free</b>        |
| 1 | Participation in the Annual General Meetings (AGM) of the organization                     | √ *                              | √ *                           | √ †             | √                  |
| 2 | Participation in the Extraordinary General Meetings (EGM) of the organization              | √ *                              | √ *                           | √ †             | √                  |
| 3 | The right to vote on policy issues of the organization (in meetings or on-line formats)    | √ *                              | √ *                           | √ †             |                    |
| 4 | Participation in public events and activities of the organization                          | √                                | √                             | √               | √                  |
| 5 | Personalized identification badge for certified guides with the GUIDEKS / FEG / WFTGA logo | √                                | √                             |                 |                    |
| 6 | GUIDEKS business card for certified guides with the GUIDEKS / FEG / WFTGA logo             | √                                | √                             |                 |                    |
| 7 | Opportunities for training with promotional prices offered by GUIDEKS                      | √                                | √                             | √               |                    |



|    |  |   |   |   |   |
|----|--|---|---|---|---|
| 8  | Opportunity to run for and be selected as a member of the Executive Board  | √ | √ |   |   |
| 9  | Opportunity to provide guiding services on behalf of GUIDEKS <sup>(6)</sup>  | √ | √ |   |   |
| 10 | Opportunity to be involved in the organization's projects depending on the professional profile  | √ | √ | √ | √ |
| 11 | Promotion of personal profile with text and photo on the GUIDEKS website and social media  | √ | √ |   |   |
| 12 | Promotion in the list of organization members on the GUIDEKS website   | √ | √ | √ | √ |
| 13 | Representation of the organization in the media / forums / conferences / various local or international meetings (With authorization of the Director or Executive Board) | √ | √ | √ | √ |
| 14 | Access to the organization's internal database with information about guides, tourism, tourist sites in Kosovo, laws, standards, strategies and additional literature.   | √ | √ |   |   |

\* Mandatory † Non-mandatory

## MEMBERSHIP PAYMENT

The annual membership payment is made to the bank account of the GUIDEKS organization at TEB 2032 0001 6945 9542 with the following description: "GUIDEKS Membership Year 20XX First Name Last Name". Payment must be made by bank transfer/e-banking or bank deposit. Cash payments are not accepted.

Payment for each calendar year must be made by February 1 of the respective year unless otherwise specified in an additional notice by GUIDEKS. This is especially important if members wish to participate in the annual Assembly meeting where they may also have the right to vote.

If the payment is made after February 1st or a new member is accepted after this date, the benefits will be available from the payment date. In these cases, partial payment will not apply, but only for a full year of membership.

---

<sup>(6)</sup> For professional engagement as a tourist guide on behalf of GUIDEKS, in addition to paying taxes and pension contributions, the organization applies an additional administrative fee of 10% of the amount for net payments over 80 Euros (for one engagement).

In case of non-payment of membership on an annual basis, the member remains an Ordinary Member until the membership fee for the respective category is paid.

### **TERMINATION OF MEMBERSHIP**

Membership of any member may terminate or be suspended pursuant to sections 4.3 of the Statute of the organization "*Membership of any member may also terminate or be suspended by a decision of the Assembly of Members if the member conflicts with the statute of the organization, misuses the position and name of the organization by the designated member, which may cause financial or reputation damage to the organization. In the event of a suspension, the duration of the suspension shall be determined.*"

A member of the organization may also be terminated by decision of GUDIEKS in case of violations of the organization's Code of Ethics. Voting in the Assembly of Members does not apply in these cases.

Member of the organization may voluntarily leave if she/he sends an email/written statement to the organization including the leaving date and the reason for leaving. In the event of a person's withdrawal from membership, the organization does not refund membership fees for that year's paid membership.

*Approved on (date) 22 February 2025 in Vushtrri by the GUIDEKS Members Assembly.*

*Note: With this Regulation, Regulation 1/2020 on the categorization, obligations and benefits of GUIDEKS membership, approved on 26 January 2020 and updated on 5 March 2022, ceases to function.*